



2015 - 2016

Monitorimi i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe Zyrës për Çështje Gjinore dhe Mundësi të Barabarta në Komunën e Gjakovës

PËRGATITUR NGA:

George Williams Youth Association in Kosovo

PARTNERËT

DHE DONATORËT

George Williams
Youth Association

The Official Representative of the
World YMCA in Kosovo



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo



Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e George Williams Youth Association dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së dhe KCSF-së.

Botimi është shkruar nga organizata jo-qeveritare George Williams Youth Association in Kosovo me ekipin përgjegjës të përbërë nga:

Dorina Davies
Dorina Gllogjani
Qëndrim Lluka
Laura Qarkaxhija

George Williams Youth
Association in Kosovo

Rr.Ismail Qemali Pn.
50000 Gjakova Kosova

Përmbajtja

1. Akronimet e përdorura në botim.....	3
2. Kush është organizata George Williams Youth Association in Kosovo (GWY)	4
3. Fakte rreth popullsisë dhe rinise në Gjakovë.....	4
4. Hyrje.....	5
5. Qëllimi i monitorimit.....	5
6. Procesi dhe metodat e monitorimit.....	6
7. Angazhimi i palëve me interes.....	6
8.PJESA E PARË - Monitorimi i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjakovës.....	7
9. Funksioni dhe detyrat e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Gjakovës.....	8
10. Aktivitetet e monitorimit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Gjakovës.....	9
11. Pyetjet për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport nga GWY.....	9
12. Fondet e shpenzuara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Gjakovës për vitin 2016.....	11
13.Rekomandimet nga GWY për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Gjakovës.....	12
14. PJESA E DYTË - Monitorimi i Zyrës për Çështje Gjinore dhe Mundesi te Barabarta në Komunën e Gjakovës.....	13
15.Funksioni dhe detyrat e Zyrës për Çështje Gjinore në komunën e Gjakovës.....	14
16. Aktivitetet e monitorimit të Zyrës për Çështjet Gjinore në komunën e Gjakovës.....	15
17. Pyetjet nga monitorimi i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të implementuar nga GWY.....	15
18.Projektet që janë realizuar në vitet 2015-2016 nga zyra për Barazi Gjinore në Komunën e Gjakovës.....	16
19 Rekomandimet nga organizata GWY drejtuar Zyrës për Çështje Gjinore.....	18

Akronimet e përdorura në botim

George Williams Youth Association in Kosovo - GWY

Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë - SCO-K

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile - KCSF

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjakovës - DKRS

Zyra për Çështje Gjinore dhe Mundësi të Barabarta në Komunën e Gjakovës - ZBGJ

Projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike - DSP

Agjencioni për Barazi Gjinore - ABGJ

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL

Zyra Këshilluese për Qeverisje të Mirë për të Drejtat e Njeriut - ZKQDMNJ

Zyra e Kryeministrat - ZK

Kush është organizata George Williams Youth Association in Kosovo (GWY) ?

George Williams Youth Association në Kosovë është organizatë jo qeveritare dhe është përfaqësuese e YMCA Botës me akronim GWY.

Ne jemi bazuar në vlerat e vullnetarizmit, që për qëllim ka inspirimin dhe inkurajimin e liderisë tek të rinjtë dhe asiston në një ambient të shëndetshëm të komunitetit. Vizioni ynë për Kosovë është të bëhem një organizatë e fortë dhe kredibile e cila punon në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Të ndërtojmë lidera të së tashmës dhe të së ardhmës duke investuar në fuqizimin e rinisë.

Zyra jonë nationale për Kosovë gjindet në Gjakovë. Për momentin punojmë në komunat e Gjakovës, Junikut, Pejës dhe Prishtinës, kemi më tepër se 600 përfitues direkt që janë pjesëtarë aktiv për çdo javë në programet tona. Indirekt, kemi arritur rreth 40 000 persona të shoqërise sonë. Duke e llogaritur ndikimin e pjesmarrësve aktiv dhe vetëdijësimin e shoqërisë në bazë të kampanjave dhe programeve të ndryshme.

GWY në muajin Maj 2016, është bërë anëtare me të drejta të plota në “Federatën Evropiane të YMCA”. YMCA është organizatë, e themeluar në Angli në 1844 nga Sir. George Williams me mision për të ndërtuar një shoqëri më të shëndoshë. YMCA është organizata më e madhe dhe më e vjetër jo profitabile në Botë, e ndërtuar në baza vullnetare. YMCA themeloi Kryqin e Kuq Ndërkombëtar, Peace Corps, Sportet si Basketbolli, Volejbolli, Raketball dhe shumë sporte të tjera. Gjithashtu në YMCA jane ndërtuar programet e para të zhvillimit për kujdesin ndaj fëmijëve. Qendrat rimore të YMCA-së janë ndër më të famshmet në shtetet e zhvilluara si: SHBA, Kanda, vendet e Evropës perëndimore etj. Për momentin YMCA ndodhet në 119 shtete dhe ka mbi 58 milion pjesmarrës aktivë çdo vit.

Fakte për rini në Komunën e Gjakovës

Sipas Agjensis së Statistikave të Kosovës popullsia në Kosovë arrin numrin 1.78 milion banorë dhe konsiderohet si popullata me perqindjen më të madhe të rinisë në rajon, 0-14 vjet përbëjne 29% e populatës. Njëherit Gjakova si Komunë ka afërsisht 97.000 banorë ku ndër ta 28% përbëjnë individë prej moshës 15-29 vjet. Në Gjakovë 3.4 % e popullsisë vijojnë shkollimin universitar, nga këta 1.5% janë femra kurse 1.9 % janë meshkuj. 6.1 % vijojnë shkollimin e mesëm të lartë, nga këta 2.7% janë femra kurse 3.4 % meshkuj. 0.2 % e popullsisë së gjakovës ndjekin shkollimin master pasuniversitar 0.12 % janë femra kurse 0.08% janë meshkuj.

Organizata George Williams Youth Association (GWY) është duke e implementuar programin “Krijimi i hapësirës së sigurtë për të rinjtë”, ky program ka dy komponenta bazë, komponenta e parë është fuqizimi i të rinjve në Komunën e Gjakovës dhe komponenta tjetër është promovimi i barazisë gjinore tek të rinjtë. Ndërsa një komponente tjetër është planifikuar që të bëhet edhe monitorimi i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) dhe monitorimi i Zyrës për Çështje Gjinore dhe Mundësi të Barabarta (ZBGJ) në Komunën e Gjakovës, ky monitorim përfshin vitet 2015/2016. Programi “Krijimi i hapësirës së sigurtë për të rinjtë” është program institucional i cili është duke u implementuar nga GWY prej tetorit të vitit 2015 dhe do të përfundojë në shtator të vitit 2017.

Programi është financuar nga projekti “Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP)” – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Monitorimi i DKRS dhe ZBGJ-së është paraqitur si nevojë në komunën e Gjakovës për të kuptuar më tepër punën e këtyre departamenteve, që të mund të ndihmojmë në zhvillimin e efektivitetit së saj në mënyrë që të kontribuojmë në fuqizimin e rinisë së Gjakovës.

Po ashtu, duke marrë parasysh që puna e organizatës GWY në Kosovë bazohet kryesisht në punën me të rinjtë, ky monitorim është një veprim i rëndësishëm, që na mundëson të ndërtojmë ose të forcojme më tepër bashkëpunimin me akterët lokal dhe të kontribuojmë në zhvillimin e punës tonë të përbashkët, në të ardhmen për të rinjtë e vendit tonë.

Qëllimi i monitorimit

Programi “Krijimi i hapësirës së sigurtë për të rinjtë” është i fokusuar në fuqizimin e rinisë dhe promovimin e barazisë gjinore tek të rinjtë edhe qëllimi i këtij monitorimi për dy departamentet, DKRS dhe ZBGJ në Komunën e Gjakovës është promovimi i vizibilitetit dhe transparencës së punës së tyre për dy vite 2015 dhe 2016. Njëherit në bazë të monitorimit ne do të mund të ndihmojmë këto departamente komunale që të rrisin impaktin e punës së tyre në të mirë të rinisë së Gjakovës, me anë të disa rekomandimeve nga ne si shoqëri civile. Gjithashtu ky monitorim na ka mundësuar që bashkëpunimi i organizatës sonë GWY, me akterët lokal dhe me departamentet komunale në fjalë të jetë më korrekt, transparent dhe më i shpeshtë.

Procesi dhe metodat e monitorimit

Monitorimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS) në Komunën e Gjakovës ka filluar të bëhet prej muajit nëntor të vitit 2015 dhe ka zgjatur deri në muajin dhjetor të vitit 2016. Kurse monitorimi i Zyrës për Çështje Gjinore ka filluar në muajin Janar 2016 dha ka vazhduar për 12 muaj. Gjatë kësaj periudhe organizata jonë ka mbajtur vazhdimisht takime me zyrtarët komunal, si në DKRS gjithashtu edhe me Zyren për Çështje Gjinore. GWY në fillim të procesit të monitorimit, ka mbajtur një takim me kryetarët e komunës së Gjakovës znj. Mimoza Kusari Lila duke e njoftuar atë për monitorimin. Gjithashtu kemi organizuar tri tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues të ndryshmëm të akterëve lokal dhe qendror me temat që prek ky monitorim. Nga këto tryeza të rrumbullakëta, kanë dalur disa rekomandime të cilat i janë dërguar në DKRS dhe Zyrës për Çështje Gjinore në Komunën e Gjakovës, gjithashtu janë paraqitur edhe në monitorim.

Angazhimi i palëve me interes

Palët e interesuara për këtë monitorim siç janë Komuna e Gjakovës dhe përfaqësuesit e Drejtorisë së Kulturës, Rinis dhe Sportit, Zyrtarja përgjegjëse për Zyrën për Çështje Gjinore, poashtu akterët tjerë të cilët janë përfaqësues të shoqërisë civile në Gjakovë janë treguar të gatshëm dhe të interesuar të ndihmojnë në procesin e monitorimit të këtyre departamenteve në Komunën e Gjakovës.

Zyrtarë komunal të departamenteve që janë monituruar janë treguar të gatshëm për të marrë pjesë si panelistë në tryezat e diskutimit të organizuara në lidhje me çështjet e të rinjve dhe të barazisë gjinore dhe çdo herë janë treguar të hapur për t'u takuar dhe për t'u përgjigjur pyetjeve të bashkangjitura me kërkesën për monitorim, brenda kohës dhe nuk kanë hezituar për të na sqaruar çdo paqartësi që kemi pasur.

Megjithatë, kemi hasur në hezitim të Kryetarës së Komunës së Gjakovës për t'u takuar dhe për ta njoftuar në lidhje me procesin e monitorimit dhe dorëzimit të rekomandimeve të dalura nga tryeza e rrumbullakët ku është diskutuar për të drejtat e barabarta në pronë, por ato rekomandime janë procesuar në arkivën komunale dhe janë dërguar tek Zyrtarja për Çështje Gjinore.

Monitorimi i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjakovës

Detyrat e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Gjakovës janë:

Menaxhon me resurset sportive, kulturore dhe rimore në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive.

Për qytetarët, grupet e interesit, institucionet arsimore, klubet sportive dhe kulturore ofron këto shërbime me bazë ligjore, si ligji mbi sportin, nr. 2003/24 si dhe në Statutin e Komunës:

- Trajton kërkesat dhe ofron mundësitë për shfrytëzimin e hapësirave të Pallatit të Sporteve "Shani Nushi", para së gjithash sallën e madhe për rekreacion dhe sport.
- Trajton kërkesat dhe ofron mundësitë në shfrytëzimin e hapësirës për reklamim në Pallatin e Sporteve "Shani Nushi".
- Trajton kërkesat dhe ofron mundësitë për shfrytëzimin të:
 1. Sallës së madhe të Pallatit të Sporteve "Shani Nushi" për zhvillimin e garave zyrtare sportive,
 2. Sallës së madhe të Pallatit të Sporteve "Shani Nushi", për koncerte të ndryshme të karakterit komersial,
 3. Hapësirave jashtë Pallatit të Sporteve "Shani Nushi", si fushat e futbollit, hendbollit, basketbollit dhe volejbollit.

Në bazë të udhëzimit administrativ, Nr.05/2005, mbi Shfrytëzimin e Objekteve Komunale dhe të Statutit të Komunës së Gjakovës 01 Nr.011-332/2010 (21.01.2010), ofrohen këto shërbime për qytetarët, grupet e interesit, institucionet arsimore dhe kulturore:

- Trajton kërkesat dhe ofron mundësitë për shfrytëzimin të:
 1. Sallës universale të Pallatit të Kulturës "Asim Vokshi",
 2. Sallës së leximit dhe sallës së provave në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi",
 3. Foajeut, si dhe të Galerisë së Arteve të Pallatit të Kulturës "Asim Vokshi".

Në bazë të ligjit për Bibliotekat 04/L-097, Financimi, Neni 13, Pika 6, mandej të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale 01.Nr.011-43964, dt. 06.07.2015, si dhe të Statutit të Komunës së Gjakovës 01.Nr.011-332/2010, dt. 21.01.2010, Neni 53, Pika C.C, trajton kërkesat dhe ofron mundësitë e shfrytëzimit nga subjektet fitmprurëse dhe jo fitimprurëse të hapësirave të Bibliotekës "Ibrahim Rugova".

Në bazë të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale 01.Nr.011-43964, dt.06.07.2015, si dhe të Statutit të Komunës së Gjakovës, 01.Nr.011-332/2010, dt. 21.01.2010, Neni 53, Pika C.C, trajton shfrytëzimin e hapësirave të muzeve.

Gjatë monitorimit të DKRS-së në Komunën e Gjakovës janë mbajtur takime të ndryshme, duke filluar me takimin e parë me Kryetaren e Komunës së Gjakovës, znj. Mimoza Kusari Lila për të njofuar atë që në kuadër të projektit për të rinjë "Krijimi i hapësirës së sigurtë për të rinjtë" ne si organizatë jo – qeveritare do të bëjmë monitorimin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe zyrës për Barazi Gjinore në Komunën e Gjakovës. Pastaj kemi vazhduar me takime të tjera me drejtorin e drejtorisë për DKRS z.Meriton Ferizi, ku me anë të këtyre takimeve dhe bashkëpunimeve kemi biseduar se cilët do të mund të ishin hapat e nevojshëm që ne do të mund të bënim dhe të zhvillonim punën tonë të përbashkët dhe po ashtu, me anë të këtyre takimeve ne kemi marrë disa informata të cilat tregojnë më së miri punën e DKRS-së.

Po ashtu, gjatë monitorimit janë mbajtur edhe tryeza të rrumbullakëta për të rinjët me temat:

- Tryeza e parë është mbajtur me 15 Dhjetor 2015 me temë: Plani i veprimit për rini dhe planifikimi buxhetor në sektorin e rinisë në Komunën e Gjakovës"
- Tryeza e dytë është mbajtur me 05 Maj 2016 me temë: "Planifikimi buxhetor dhe prioritizimi i nevojave të rinisë në Komunën e Gjakovës".

Në tryezat e cekura më lartë kanë dal rekomandime të ndryshme në të cilat është bazuar ky monitorm. Një nga rekomandimet ishte krijimi i nënkopit buxhetor për rini. GWY ka mbajtur shumë takime me zyrtarë komunal duke e shtyrë procesin e nënkopit buxhetor, vlenë të ceket takimi me Drejtorin për Buxhet dhe Financa z.Teki Shala i cili e ka mirëpritur këtë rekomandim nga akterët e shoqërisë civile.

Pyetjet për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport nga GWY

Në pyetjet e bëra nga organizata jonë DRKS është përgjigjur kështu:

Sa është buxheti total i DKRS, për vitet 2014/2015/2016? (Specifikoni për secilin vit)?

Për vitin 2014 DKRS ka shpenzuar 130.000,00 euro nga fondi i Qeverisë së Kosovës.

Për vitin 2015 DKRS ka shpenzuar 125.000,00 euro nga fondi i Qeverisë së Kosovës.

Për vitin 2016 DKRS ka shpenzuar 100.000,00 euro nga fondi i Qeverisë së Kosovës.

Ku dhe si bazohet kërkesa e DKRS ndaj Komunes së Gjakovës për buxhetin vjetor të DKRS-së?

Kërkesa e DKRS për buxhetin vjetor shkon sipas planifikimit, normalisht me kërkesë shumë më të madhe dhe të favorshme për 3 sektoret, por pastaj mundësitë dhe shkurtimet buxhetore, gjithashtu edhe rekomandimet nga Ministria e Financave, na caktojnë kufijtë real të shpërndarjes së buxhetit.

**Sa është shuma totale e shpenzuar për sektorin e rinisë, për vitet 2015/2016?
(Specifikoni për secilin vit).**

Si e ndarë enkas për organizatat rimore është viti 2016 me 10.000,00 euro subvencione, pasiqë në vitin 2015 është aprovuar në asamblenë Komunale Plani i Veprimit për vitin 2016.

**A është llogaritur buxheti në bazë të planeve të veprimit në sektorin e rinisë, për vitin 2015?
(Specifikoni për secilin vit). Nëse po, si janë shpenzuar fondet për rini në përpjekje me planet e veprimit?**

Jo, sepse nuk ka pasur ndarje të buxhetit për këtë vit.

Nuk pasur fonde të ndara për këtë vit, prandaj, nuk ka pasur se si të shpenzohen fondet, e vetmja mënyrë e përkrahjes ka qenë ofrimi i hapësirave, infrastrukturës si dhe logistikës pa pagesë.

Sa është realizuar plani i veprimit për rini për vitin 2016? Sa janë shpenzuar nga DKRS për realizimin e planit të veprimit për sektorin e rinisë për vitin 2016?

Të gjitha komponentat e planit janë përfshirë, përpos komponentës së punësimit, pasi që kjo komponentë është duke u realizuar në bashkëpunim me GIZ-in, Ministria për Punë dhe Mirëqenje Sociale.

Pasiqë ka qenë viti i parë i planifikuar për rini, e gjithashtu për realizimin e Planit të Veprimit, janë ndarë 10,000.00 euro të cilat ndërlidhen kryekëput me Planin e Veprimit, me komision monitorues dhe në fund të vitit me raport të hollësishëm.

Specifikoni për secilin vit, aktivitetet ku është shpenzuar fondi për rini, për vitet 2015/2016?

Për vitin 2015 ku nuk është ndarë buxhet i veçantë (dedikuar) për Rini, është ndihmuar në forma të ndryshme si: Infrastrukturë, Zyre, hapësira, transport, karburante, heqja e shpenzimeve të komunalive: (uji, nxemja, rryma).

Sa është shuma e subvencioneve të dhëna në sektorin e rinisë dhe nga zyra e Kryetares së Komunës për rini për vitet 2015/2016? Si ishin kriteret e përfitimit të subvencioneve dhe kush ishin përfituesit?

Për vitin 2015 DKRS nuk ka ndarë subvencione për rini, ndërsa sa i përket vitit 2016 janë ndarë 10.000 euro nga DKRS. Nuk kemi çasje në subvencionet e Kryetarës, pasiqë ato menaxhohen nga Zyra e Kryetares dhe mundësish këtë pyetje e drejtoni atje sepse andej ndihmohen kategori të ndryshme si nga organizatat Rinore, barazia Gjinore, komunitetet, etj.

A do të hyj në fuqi nën - kodi për rini nga viti 2017?

Po, kodi i veçantë për Rini ka kaluar në vitin 2016 në asamable, me buxhetin e vitit 2017 dhe duhet theksuar përfund se nga 6 organizata rimore funksionale në vitin 2014, sot numërojmë 37 aktive të regjistruara, çka tregon se është shtuar dukshëm bashkëpunimi i ndërsjellë.

Fondet e shpenzuara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Gjakovës për vitin 2016.

Lista e projekteve te realizuara në vitin 2016

Projektet		Organizatat implementuese	Shpenzimet
1	Sensibilizimi i të rinjëve në vendimmarrje	OJQ INNO	880 €
2	Formimi dhe fuqizimi i grupeve jo - formale rinore në zonat rurale	OJQ – Qendra Kreative Cermjan	1,580.40 €
3	Fuqizimi i Këshillave të nxënësve dhe rëndësia e këshillave të shkollave	OJQ- RAGJ	900 €
4	Ngritja e vetëdijes së të rinjëve për mbrojtjen e ambientit dhe promovimi i sportit Hiking	OJQ "IQE	1,020 €
5	Edukimi i të rinjëve në shkrim dhe lexim për të verbër	Shoqata e të Verbërvë në Gjakovë	1,197.80
6	Promovimi i të drejtave të rinjëve me nevoja të veçanta	Handikos	1,515 €
7	Bashkëpunimi i të rinjëve në mes të komuniteteve përmes aktivitete kulturore	RKE	1,194 €
8	Këshilli i Veprimit Rinor Lokal – subvencion	KVRL	1,000 €
	Totali		9,287.2 €

Rekomandimet nga organizata GWY për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Gjakovës

Në kuadër të projektit “Krijimi i Hapsirave të sigurta për të rinjë” i cili implementohet nga organizata jonë GWY në Komunën e Gjakovës, është organizuar tryeza e rrumbullakët me temë “Planifikimi buxhetor dhe prioritizimi i nevojave të rinisë në Komunën e Gjakovës”. (Organizuar me datë 05 Maj 2016 në Gjakovë)

Rekomandimet e dalura nga shoqëria civile drejtuar Komunës së Gjakovës

1. Të krijohet Komiteti Drejtues i Implementimit të Planit të Veprimit që të shtyjë implementimin e Planit të Veprimit për Rini në Komunën e Gjakovës.
2. Të bëhet organizimi i ditës së rinisë me 12 Gusht në bashkëpunim me të gjitha OJQ-të, dhe gjithashtu propozohet të bashkpunohet më shume me MKRS.
3. Para ndarjes së granteve të bëhet një sesion informues për organizatat e shoqerise civile.
4. Të organizohen trajnime për punëtorët e rinisë në Gjakovë nga Drejtoria për Rini.
5. Komuna të jetë akter mbeshtetës dhe promovues më i madh në punesimin e të rinjëve.
6. Të përkrahet puna vullnetare dhe të krijojen marrëveshje me OJQ-të në Gjakovë që punojnë me rini në promovimin e punës vullnetare.
7. Të mbeshteten më shumë të rinjët që marrin pjesë në programe ndërkombetare nga Komuna e Gjakovës për ndërtim të kapaciteteve.
8. Të bëhet rishikim i planit te veprimit për vitin 2017.

Rekomandimet nga tryeza e rrumbullaket “Plani i veprimit rinor lokal 2015 - 2017 – Rekomandimet nga shoqëria civile për zbatim te tij - Komuna e Gjakovës”:

1. Të paraqitet sigurt sa do të bëhet buxheti për planin e veprimit.
2. Të krijohet një këshill organizativ që shtyn implementimin e këtij plani.
3. Të bëhet nën kodi buxhetor për rini.
4. Grandet për një linjë buxhetore të hapen nga komuna 2 herë në vit për të njejtën fushë nëse nuk kishte fitues të grandit për të parën herë që është hapur grandi.
5. Organizimi i ditës/javës së rinisë, 12 gushtit të bëhet në bashkëpunim me të gjitha OJQ-të dhe institucionet në sektorin e rinisë.
6. Llogaritja e punës vullnetare si punë praktike.
7. Të krijojmë më tepër aktivitete me të rinjtë me nevoja të veçanta si në sport, kulturë dhe rekreacion duke i përfshirë me të rinjtë e tjerë.
8. Gjatë vetëdijesimit të fëmijëve për temat diskriminimi, paragjykimi dhe barazia gjinore, të përfshihen edhe prindërit në aktivitetet e vetëdijesimit. Komuna të bëjë një plan dinamik për vetëdijesimin e fëmijëve së bashku me prindër në bashkëpunim me DKA dhe DKRS.
9. Të organizohen trajnime për punëtorët e rinisë, të përfshihet QAP.
10. Të përfshihen grupe të rinjësh nga zona rurale të bëjnë aktivitete edhe ne qytet.
11. Të krijohet një komision nga komuna për transparencë që të mos bëhet duplikimi i aktiviteteve.
12. Çdo OJQ në Gjakovë të krijoj një raport vjetor dhe të paraqitet në portalin e Gjakovës njëheras të publikohen nga komuna.

Monitorimi i Zyrës për Çështje Gjinore dhe Mundësive të Barabarta në komunën e Gjakovës

Funksioni dhe detyrat e Zyrës për Çështje Gjinore në komunën e Gjakovës

Në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore Nr.2004/2 Pozita e Zyrtarëve për Çështje Gjinore janë themeluar në Kosovë për të siguruar perspektivën gjinore në nivelin komunal. Zyra për Çështjet Gjinore, Mundësi të Barabarta, ka për detyrë që të promovojojë mundësi të barabarta për të gjithë, pa marrë parasysh përkatësinë gjinore, fetare, etnike, moshe e race, të promovojojë vlerat për të drejtat e njeriut, si dhe të kujdeset për zbatimin e standardeve dhe raportimin mbi të njejit.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në komunë kontribuon në promovimin, avancimin, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me theks të veçantë respektimin e barazisë gjinore.

Detyrat e Zyrës për Barazi Gjinore janë:

- Të kordinojë dhe mbikqyrë të gjitha aktivitetet që promovojnë barazinë gjinore ne komunë;
- Të kontribuojë në formulimin e planeve dhe të politikave mbrenda komunës që ndërlidhen me barazinë gjinore;
- Të marr pjesë në panelin për rekrutimit te shërbyesve civil në komunë, për të siguruar respektimin e të drejtës gjinore;
- Mbajtja e statistikave bazë të shënimiveve, dhe i analizon ato nga perspektiva gjinore;
- Të iniciojë programe dhe projekte për të përmirësuar përfaqësimin gjinor në shërbimin civil në komunë, duke përfshirë avancimin e pozitës së gruas në struktura të larta të shërbimit civil;
- Të marr pjesë në hartimin e akteve të nxjerrura nga komuna, duke siguruar që aktet të janë në pajtim me parimet themelore të të drejtave të njeriut respektivisht të grave;
- Të bashkëpunojë me të gjitha strukturat e nivelit lokal për të avancuar dhe mbrojtur të drejtat e grave;
- Ndihmon dhe përkrahë trajnimet e organizuara që kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes për avancimin e barazisë gjinore në komunë;
- Të këshillojë dhe udhëzojë organet e komunës lidhur me çështjet gjinore dhe respektimin e të drejtave të grave;
- Të përfaqësojë komunën në takimet e ndërlidhura për çështjet gjinore;
- Bashkëpunon me zyrtare/in për barazi gjinore të MAPL-së dhe me Agjencinë për Barazi Gjinore të Kosovës, Zyrën e kryeministrat/Zyrën për Qeverisje të mirë dhe të drejtave te Njeriut;
- Merr pjesë në koordinimin e OJQ-ve lokale dhe ndërkombëtare dhe punon drejtë zhvillimit dhe avancimit të çështjeve gjinore;
- Përgatitë raporte javore, mujore dhe vjetore mbi çështjet gjinore në komunë, dhe i përcjellë në ABGJ dhe MAPL, ZK / ZKQMDNJ.

Aktivitetet e monitorimit të Zyrës për Çështjet Gjinore në komunën e Gjakovës

Monitorimi i Zyrës për Çështjet Gjinore është zhvilluar nëpërmjet disa proceseve prej të cilave më të shpeshta kanë qenë takimet që janë mbajtur me zyrtaren përgjegjëse. Që në fillim të implementimit të projektit jemi takuar me zyrtaren e Zyrës për Çështje Gjinore dhe Mundësi të barabarta zj. Lumnije Shllaku, te cilën e kemi informuar për projektin dhe për të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen në kuadër të komponentës për Barazi Gjinore duke përfshirë këtu edhe monitorimin e punës së kësaj zyre. Pjesë e atyre aktivitetave ishte edhe tryeza e rrumbullakët e treta me radhë e organizuar nga GWY. Tryeza e tretë është mbajtur me 13 Korrik 2016 me temën "E drejta e pronës dhe edukimi i të rinxve lidhur me të", zyrtarja nga ZGJB zj. Lumnije Shllaku ishte e ftuar si paneliste në këtë tryezë. Rekomandimet e dalura janë dërguar tek ZGJB. Por nuk kemi pasur mundësi të takoheshim me Kryetarën e Komunës së Gjakovës Zj. Mimoza Kusari Lila që të bisedonim rreth rekomandimeve të dalura. Stafi GWY ka tentuar disa herë të takoheshim me Kryetaren e Komunës, një herë kanë shkuar së bashku me Zyrtaren e ZGJB-së por kabineti i kryetarës i kanë udhëzuar që të dërgojnë email për takim, por edhe ky veprim kishte rezultuar pa sukses.

Pyetjet për Zyrën për Çështje Gjinore dhe Mundësi të Barabarta në Komunën e Gjakovës nga GWY

Në pyetjet e bëra nga organizata jonë, ZBGJ është përgjigjur kështu:

Sa është buxheti total i Zyrës për Çështje Gjinore pranë Komunës se Gjakovës për vitet 2015/2016?

Zyra për Çështje Gjinore e komunës se Gjakovës nuk ka buxhet të veçantë.

Ku dhe si bazohet kërkesa e Zyrës për Çështje Gjinore ndaj Komunës së Gjakovës për buxhet të Zyrës për Çështje Gjinore?

Zyra për Çështje Gjinore e parashtron kërkesën në Bord të Drejtoreve për shqyrtim për mbulimin e aktivitetave të parapara sipas planit të punës.

Sa është shuma e shpenzuar nga subvencionet/grandet për barazi gjinore dhe si është shpenzuar ai fond për vitet 2015/2016?

Siq ju njoftova më lart Zyra për Çështje Gjinore e prezanton kërkesën në Bord të Drejtoreve për shqyrtim, varësisht prej kërkesës fondet për mbulimin e aktivitetave ndahen nga subvencionet e Kryetares dhe nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme dhe Personelit në shumicen e rasteve.

Për vitin 2015 janë shpenzuar 4740 euro të cilat kanë qenë përkrahje financiare nga Komuna e Gjakovës dhe 5420 euro kanë qenë përkrahje financiare nga donatorët. Gjithsej nga kjo zyrë për vitin 2015 janë shpenzuar 10160 për projekte të ndryshme.

Për vitin 2016 janë shpenzuar 3235 euro të cilat kanë qenë përkrahje financiare nga Komuna e Gjakovës dhe 4200 euro të cilat kanë qenë përkrahje financiare nga donatorë të ndryshëm. Gjithsej 7435 euro të cilat janë shfrytëzuar për mbulimin e aktivitetave të kësaj zyre.

Pyetjet për Zyrën për Çështje Gjinore dhe Mundësi të Barabarta në Komunën e Gjakovës nga GWY

A ekziston plani vjetor i punës i Zyrës për Çështje Gjinore? Nëse po, si janë shpenzuar fondet në përputhje me planin e punës?

Zyra për Çështje Gjinore – Drejtat e Njeriut çdo vit e harton planin e punës. Zyrtarja për Çështje Gjinore në komunë kontribuon në promovimin, avancimin, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me theks të veçantë respektimin e barazisë gjinore. Në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore Nr.05/L-020 Pozita e Zyrtarëve për Çështje Gjinore janë themeluar në Kosovë për të siguruar perspektivën gjinore në nivelin komunal. Zyra për Çështjet Gjinore, Mundësi të Barabarta ka për detyrë që të promovoje mundësi të barabarta për të gjithë, pa marrë parasysh përkatësinë gjinore, fetare, etnike, moshe e race, të promovoje vlerat për të drejtat e njeriut, si dhe të kujdeset për zbatimin e standardeve dhe raportimin mbi të njëjtit.

Zyra për Çështjet Gjinore, Mundësi të Barabarta funksionon në pajtim me dispozitat e Shërbimit Civil të Kosovës. Po ashtu kjo Zyrë kujdeset për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, Ligjin kundër Diskriminimit, Ligjin për përdorimin e gjuhëve, Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare, Udhëzimin Administrativ mbi Mundësi të Barabarta, për zbatimin e politikave për Personat me aftësi të kufizuar etj. Plani i punës i ZBGJ është realizuar mbi 80% per mbulimin e aktiviteteve te shpenzuara nga fondet e lart përmenduara dhe nga donatorët potencial si:

UNWOMEN, OSBE, UNICEF, UNDP, etj.

Projektet që janë realizuar në vitet 2015-2016 nga zyra për Barazi Gjinore në Komunën e Gjakovës:

Lista e projekteve të realizuara në vitin 2015				
	Projektit	Përkrahja financiare nga komuna	Përkrahja financiare nga donatorët	Shpenzimet
1	Konferenca rajonale "Sfidat dhe të arriturat e gruas shqiptare në periudhën e pas luftës" (mbështetje nga UN WOMAN)	2,000 €	2,000 €	4,000 €
2	Fushatë një mujore mbi edukimin shëndetësor – riprodhues të grave	400 €		400 €
3	Vizitë në K.K. të Mitrovicës me GGA, qëllimi i vizitës shkëmbimi i përvojave në mes dy komunave. (Shpenzimet e transportit)	60 €		60 €
4	Takime të rregullta me anëtaret e MKDHF (mbështetje nga UN WOMAN)	250 €	1,800 €	2,050 €
5	Takime me OJQ- të lokale dhe GGA	148 €		148 €
6	Shënim i ditës ndërkombëtare të Evropës 9 Maji	100 €		100 €
7	Organizimi i marshit ne mbështetje të kryetares (Baner)	100 €		100 €

Projektet që janë realizuar në vitet 2015-2016 nga zyra për Barazi Gjinore në Komunën e Gjakovës:

Lista e projekteve të realizuara në vitin 2015

Projektet		Përkatja financiare nga komuna	Përkatja financiare nga donatorët	Shpenzimet
8	Dreka në kuadër të vizitës së GGA të komunës se Mitrovicës	352 €		352 €
9	Shënim i ditës ndërkombëtare kundër kancerit të gjirit	60 €		60 €
10	Punësim një ditor i PAK në kuadër të fushatës "Muaji tector muaj i mundësive të barabarta" (mbështetje nga OSBE)	300 €	250 €	550 €
11	Në kuadër të fushatës 16 ditëshe kundër dhunës në familje	970 €	1,370 €	2,340 €
Totali		4,740 €	5,420 €	10,160 €

Lista e projekteve të realizuara në vitin 2016

		Përkatja financiare nga komuna	Përkatja financiare nga donatorët	Shpenzimet
1	Shënim i ditës ndërkombëtare të Evropës 9 Maji "Edrejta e Trashëgimisë pronësore të grave në Kosovë".	100 €		100 €
2	Fushatë një mujore mbi edukimin shëndetësor–riprodhues të grave	400 €		400 €
3	Punësim një ditor i PAK në kuadër të fushatës "Muaji tector muaj i mundësive të barabarta"	400 €		400 €
4	Shënim i ditës ndërkombëtare kundër kancerit të gjirit (Kafe dhe Pije Freskuese)	100 €		100 €
5	Panairi dy ditor	990 €		990 €
6	Takime me OJQ- të lokale dhe GGA	148 €		148 €
7	Takime të rregullta me anëtarët e MKDHF (mbështetje nga UN WOMAN)	322 €	1,800 €	2,122 €
8	Në kuadër të fushatës 16 ditëshe kundër dhunës në familje (mbështetje nga UN WOMAN, UNICEF dhe OSBE)	375 €	760€+660€+980€	2,775 €
9	Takim koordinues me anëtarët e MKDHF dhe donatorët	400 €		400 €
Totali		3,235 €	4,200 €	7,435 €

Duke u bazuar në procesin e monitorimit dhe tryezën e rrumbullakët të organizuar për Çështje Gjinore kanë dalur këto rekomandime për Zyrën për Çështje Gjinore:

1. Zyra për Barazi Gjinore së bashku me Komunën e Gjakovës dhe Shoqërinë Civile të krijoj një plan të veprimit ku mund të promovojmë barazinë gjinore dhe të drejtën e barabartë të pronës (të mirret shembulli i planit të veprimit për dhunën në familje që është implementuar nga komuna) duke përfshirë edhe të rinxjtë.
2. Zyra për Barazi Gjinore të bashkëpunojë më shumë me OJQ-të rinore për të krijuar projekte dhe fushata sensibilizuese për tema të ndryshme në lidhje me barazinë gjinore veqanërishtë për të rinxjtë.
3. Zyra për Barazi Gjinore duke bashkëpunuar më shumë me OJQ-të rinore duhet të mbajnë më tepër debate dhe diskutime të ndryshme që i përshtaten niveleve të të rinxjve, ku të rinxjtë do të kenë mundësinë të përfshihen direkt në këtë problematikë, që të ngrihet vetëdija për të drejtën e pronës dhe të drejta tjera të barabarta.
4. Duhet të ketë barazi gjinore të dyanshme, pra të ngritet vetëdija për të drejtën e pronës jo vetëm tek femrat por edhe tek meshkujt.
5. Duhet të promovojmë më tepër Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës lidhur me të drejtën e pronës dhe barazinë gjinore, të monitorojmë ligjet dhe të hulumtojmë lidhur me të drejtën e pronës së përbashkët në mes të të dy gjinive, në bashkëpunim me Komunën dhe shoqërinë civile, ku njëherësh do të analizojmë dhe bëjmë vetëdijesimin mbi procedurat legjislativë.
6. Duhet të ketë me tepër debate dhe diskutime të ndryshme që i përshtaten niveleve të të rinxjve, ku të rinxjtë do të kenë mundësinë të përfshihen direkt në këtë problematikë, që të ngrihet vetëdija për të drejtën e pronës.
7. Të krijojmë forume online ku të rinxjtë do të mund të inkuadrohen dhe të zhvillohen në këtë aspekt, në këto forume është mirë që të inkuadrohen studentët që janë në Fakultetin Juridik ku do të mund shpjegonin dhe thjeshtonin ligjet për shoqërinë.
8. Të krijojmë më tepër video, kampanja ose fushata vetëdijësuese të ndryshme, për shoqërinë, ato mund të janë sa më kreative, të drejtpërdrejta duke ligjëruar nëpër shkolla, duke u takuar me qytetarë ose duke shkuan nëpër shtëpi, gjithashtu të paraqiten në platforma online dhe media.
9. Shoqëria civile të përdor të gjithë mekanizmat ligjorë në vetëdijesim të popullsisë rreth këtyre problematikave, gjithashtu të inkuadrojmë më tepër mediat.
10. Gjyqtaret, organet legjislativë dhe OJQ-të duhet të inkurajojnë femrat që të mos heqin dorë nga prona, pasi që me ligj janë të barabartë.

George Williams Youth Association

The Official Representative of the
World YMCA in Kosovo

Monitorimi i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe
Zyrës për Çështje Gjinore në Komunën e Gjakovës
2015-2016

Ky program është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).



Email: georgewilliamsyouthassociation@gmail.com
Tel: +377 (0) 45 / 695 - 429